

STATUTI I PARTISË MUNDËSIA

Me nismën e z. Agron Siri Shehaj, themelohet Partia “Mundësia”, një lëvizje politike që synon me besimin në Zot dhe vlerat universale të njeriut, të krijojë, me përgjegjshmëri dhe vendosmëri, një të ardhme me mundësi të barabarta për të gjithë.

Të vetëdijshëm për historinë tonë, Partia Mundësia kërkon të krijojë dhe të ndërtojë një shtet të së drejtës, demokratik, social, bazuar në ekonominë e tregut dhe të drejtën e pronës, ku të gjithë njerëzit të jenë të barabartë përpara ligjit.

Duke u bazuar në frymën e tolerancës dhe bashkëjetesës, me zotimin për mbrojtjen e dinjitetit dhe personalitetit njerëzor, Partia Mundësia, synon të realizojë prosperitetin e kombit shqiptar, mirëqënien, kulturën dhe paqen, duke aspiruar, në përputhje me Kushtetutetën e Republikës së Shqipërisë, bashkimin kombëtar.

Partia Mundësia do të respektojë dhe do të nderojë vuajtjen dhe sakrificën e të gjithë atyre që u vranë, persekutuan, internuan, grabitën, torturuan dhe u përdoqën nga regjimi komunist. Sakrifica, lufta dhe vuajtjet e tyre do të kenë konsideratata dhe vlerësimin më të lartë të Partisë Mundësia dhe anëtarësisë së saj. Dënimi i krimeve të komunizmit dhe individualizimi i personave përgjegjës për këto krime, është detyrim i kësaj partie.

Qëllimi i Partisë Mundësia është të heqë të gjitha barrierat që pengojnë pjesëmarrjen në politikë të grave, duke u angazhuar me vendosmëri për siguruar në të gjitha nivelet, prezencën e barabartë të grave dhe burrave në organet drejtuese dhe ekzekutive. Ajo promovon barazinë gjinore në kandidimet e ndryshme dhe përpiqet për të arritur barazinë midis burrave dhe grave edhe në pozitat monokratike institucionale brenda kësaj partie.

Partia Mundësia, respekton autonominë dhe pluralizmine organizatave shoqërore dhe të punës, njeh dhe respekton dallimin midis sferës së iniciativës së lirë ekonomike dhe sferës së veprimeve politike. Ajo garanton të gjitha format e transparencës dhe llogaridhënies në lidhje me financimin e partisë, me një qëllim të qartë, atë të shmangies nga çdolloj ndikimi të grupeve të interesave specifike.

Partia Mundësia njeh dhe respekton pluralizmin kulturor dhe pluralizmin politik brenda saj, duke respektuar idetë dhe mendimet ndryshe, si pjesë thelbësore e jetës së saj demokratike, sikundër njeh dhe mbron me forcë të gjitha kushtet personale si gjinia, mosha, besimet fetare, aftësitë e kufizuara, raca, gjendja ekonomike, arsimore, social, orientimin seksual, origjina etnike etj, duke luftuar me forcë çdolloj forme diskriminimi.

Partia Mundësia promovon transparencën dhe ndryshimin në postet politike dhe institucionale. Kandidaturat dhe detyrat brenda partisë janë të rregulluara në mënyrë të qartë dhe paekuivoke në normat statutores që, në çdo nivel organizativ dhe për çdo sferë institucionale, bëjnë pozitat e detyrueshme të përballeshme, përveçse përcaktojnë një kufi për akumulimin dhe rinovimin e mandatit.

Partia Mundësia promovon qarkullimin e ideve dhe mendimeve, zhvillimin kolektiv të drejtiveve politike-programore, formimin e sintezave të përbashkëta, rritjen e njohurive dhe aftësive drejtuese politike, edhe përmes momenteve të studimit dhe formimit. Ajo garanton në mënyrë transparente dhe demokratike parimin e meritokracisë, si pjesë thelbësore e zhvillimit dhe rritjes së saj.

Partia Mundësia, është një parti qartësisht e pozicionuar në hapësirën politike të qendrës së djathtë, e cila duke u bazuar tek tradita të promovojë liberalizmin dhe forcimin e individit.

Sa sipër, të bindur në idetë dhe aspiratat tona, hartojmë këtë Statut, i cili është akti bazë ku do të mbështetet themelimi dhe funksionimi i partisë politike "Mundësia".

KREU I

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

NENI 1

EMËRTIMI I PARTISË

1.1. Partia mban emrin PARTIA MUNDËSIA E SHQIPËRISË dhe akronimi i saj zyrtar është "MUNDËSIA".

1.2. Kjo parti e fiton personalitetin e saj juridik, me regjistrimin e saj në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.

1.3. Partia Mundësia e zhvillon aktivitetin e saj në përputhje me Kushtetutën, legjislacionin shqiptar dhe me dispozitat e parashikuara në këtë akt.

NENI 2

SELIA E PARTISË

2.1. Partia "Mundësia" e ka selinë e saj qendrore në kryeqytetin e Republikës së Shqipërisë, Tiranë, dhe ka të drejtë për të hapur degë dhe zyra të përfaqësimit të tjera, në Shqipëri dhe jashtë saj.

2.2. Njësitë strukturore, degët dhe përfaqësitë e saj do të ndërtohen konform legjislacionit shqiptar në fuqi dhe me atë të vendeve të tjera ku ajo mund të hapë degë.

NENI 3

SIMBOLI DHE FLAMURI

3.1. Simboli i Partisë Mundësia përbëhet nga fjala "Mundësia".

3.2. Flamuri i Partisë është ngjyrë portokalli me blu.

NENI 4

VULA

4.1. Vula e Partisë Mundësia është e drejtkëndore, e përbërë nga fjala Mundësia ngjyrë portokalli dhe blu.

4.2. Vula përdoret në emër dhe për llogari të organeve qendrore të Partisë dhe të administratës qendrore ekzekutive, që janë në selinë qendrore. Struktura e Partisë në bashki kanë vulat e tyre që ruajnë modelin e përcaktuar më sipër, por duke shtuar emërtimin e strukturës përkatëse.

4.3. Rregullat për mënyrën e krijimit, ruajtjes, përdorimit dhe asgjësimit të vulës, përcaktohen me akt normativ nga Sekretariati i Përgjithshëm.

NENI 5

ORGANIZIMI

5.1. Partia Mundësia është një lëvizje politike e qytetarëve të lirë dhe të grupuar, të cilët aderojnë me vullnet të lirë, duke u organizuar në nivel kombëtar, lokal dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.

5.2. Orgaznimi i partisë në nivel lokal bëhet mbi bazën e këtyre kriterëve:

- a) ndarjen territoriale të vendit, sipas legjislacionit në fuqi;
- b) njësive sipas zonave elektorale, në përputhje me përcaktimet e Kodit Zgjedhor;
- c) mbi bazat e përfaqësimit të qytetarëve shqiptarë që jetojnë jashtë vendit;
- d) mbi bazë bindjesh dhe idesh.

5.3. Organigrama apo struktura e partisë përcaktohet nga Sekretariati i Përgjithshëm.

5.4. Struktura organizative dhe organigrama e partisë nuk mund të ndryshojë nëse janë parashikuar zgjedhje të brendshme në nivel lokal apo kombëtar.

NENI 6 KOHEZGJATJA

6.1. Partia Mundësia do të ushtroje aktivitetin e saj politik, për një periudhë kohe të pakufizuar nga data e regjistrimit të saj.

NENI 7 QËLLIMI POLITIK DHE VLERAT E PARTISË

7.1. Në qendër të vëmendjes së Partisë Mundësia është njeriu dhe e drejta e tij për të pasur mundësi për tu zhvilluar në një ambient sa më ideal për të. Ne si qenie njerëzore posedojmë një dinjitet natyror intrinsik që na bën unikë. Kjo vlen për të gjithë ata që besojnë në Zotin, burimin e së vërtetës, drejtësisë, mirësisë dhe bukurisë, ashtu si për ata që nuk ndajnë këtë besim por respektojnë gjithashtu vlerat universale të njëjta, duke i marrë nga burime të tjera.

7.2. Partia Mundësia synon të realizojë dhe mbështetë sa më poshtë vijon:

- Liria, e cila është e drejta më e rëndësishme njerëzore, është e mundur vetëm nëse shoqërohet me përgjegjësinë personale.
- Burrat dhe gratë gëzojnë të njëjtat të drejta. Kjo duhet të gjendet në të gjitha politikat.
- Të gjithë njerëzit duhet të gëzojnë të njëjtat mundësi dhe, prandaj, do të sigurojmë që të ketë në fakt këto mundësi edhe për personat me aftësi të kufizuara.
- Politikat tona bazohen në parimet e drejtësisë dhe synojnë të ndjekin të mirën e përgjithshme. Jemi të angazhuar për të luftuar në thelb çështjet e barazisë dhe varfërisë.
- Kjo është e mundur vetëm në një shoqëri e karakterizuar nga bashkërendimi dhe solidariteti, që përfshin respektin për traditat, asocionizmin dhe fushat ku njerëzit marrin iniciativë, punojnë dhe jetojnë së bashku.
- Solidariteti është një përgjegjësi e përbashkët: të fortët duhet të ndihmojnë personat në nevojë, të cilët në të njëjtën kohë duhet të përpiqen të përmirësojnë gjendjen e tyre sipas aftësive të tyre.
- Kemi një detyrim ndaj brezave të ardhshëm për të transmetuar të njëjtat mundësi, ose edhe më të mira, nga ato që i gëzojmë ne, duke mbrojtur lirinë dhe demokracinë, duke garantuar stabilitetin e financave publike dhe ruajtjen e një mjedisi të shëndetshëm.
- Vendimet politike duhet të merren sa më pranë qytetarëve; autoritetet politike nuk duhet të bëjnë atë që është brenda aftësive të vetë qytetarëve dhe që ata mund t'i bëjnë vetë, në familjet e tyre ose në organizatat qytetare.
- Sistemi i vetëm politik në të cilin këto vlera mund të zhvillohen është një demokraci pluraliste, ku qytetarët pranojnë përgjegjësinë. Koncepti më i mirë ekonomik për t'i mbrojtur ato është ekonomia sociale e tregut bazuar në qëndrueshmëri ambientale, ku konkurrenca dhe liria e ndërmarrjes janë në ekuilibër me drejtësinë sociale.

- Mbrojtja e interesave kombëtare dhe të drejtat njerëzore të shqiptarëve kudo ku janë, duke respektuar aktet e marrëveshjet ndërkombëtare dhe duke kërkuar standardet e pranuar botërisht për të gjithë.
- Nxitjen e një sistemi drejtësie të pavarur dhe të paanshëm, që i shërben qytetarëve dhe interesit publik.

NENI 8

SUBJEKTET THELBËSORE TË JETËS DEMOKRATIKE TË PARTISË

8.1. Partia Mundësia është e hapur për nivele të ndryshme të angazhimit dhe për forma të shumta të pjesëmarrjes. Për qëllimet e këtij statuti, identifikohen dy subjektet thelbësore të jetës demokratike brenda partisë: anëtarët dhe votuesit.

8.2. Me “anëtarë” kuptohen individët, që janë shtetas shqiptarë dhe ata shtetas që kanë kombësi shqiptare, të cilët jetojnë brenda apo jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, të cilët regjistrohen/anëtarësohen në parti duke nënshkruar këtë statut, programin dhe Kodin Etik.

8.3. Për qëllimet e këtij statuti, kur nuk përcaktohet ndryshe, me “votues” kuptohen personat, që janë shtetas shqiptarë dhe ata shtetas që kanë kombësi shqiptare, të cilët jetojnë brenda apo jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, të cilët deklarojnë se e njohin dhe ndjehen pjesë e ofertës politike të Partisë, që e mbështesin atë në zgjedhjet e ndryshme, dhe pranojnë që të jenë të regjistruar dhe pjesë e Regjistrit Publik të Votuesve.

8.4. Të gjithë votuesit e Partisë Mundësia kanë të drejtën të:

- a) marrin pjesë në zgjedhjet primare për zgjedhjen e kandidatëve të partisë për pozitat kryesore institucionale;
- b) marrin pjesë në Forume tematike;
- c) votojnë në referendume të hapura për votuesit dhe marrin pjesë në forma të tjera të konsultimit;
- d) kenë qasje në informacione për të gjitha aspektet e jetës së partisë;
- e) ankohen tek organet e partisë dhe të marrin përgjigje të menjëhershme nëse vlerësojnë se janë shkelur rregullat e këtij Statuti.

8.5. Anëtarët e Partisë Mundësia kanë gjithashtu të drejtën për:

- a) të marrin pjesë në zgjedhjen direkte të organeve drejtuese së partisë në të gjitha nivelet;
- b) të konsultohen në zgjedhjen e kandidaturave të Partisë Mundësia;
- c) të votojnë në referendumet e rezervuara për anëtarët;
- d) të marrin pjesë në formimin e propozimit politik të partisë dhe në zbatimin e tij;
- e) të kenë ambiente të qëndrueshme për diskutim dhe zhvillim politik;
- f) të informohen plotësisht për të qenë pjesëmarrës të vetëdijshëm në jetën e brendshme të partisë;
- g) të paraqesin kandidaturën e tyre për organet drejtuese në nivele të ndryshme dhe të nënshkruajnë propozimet e kandidaturave për zgjedhje direkte nga të gjithë votuesit;
- h) të nënshkruajnë propozimet e kandidaturave për të mbajtur detyra institucionale;
- i) marrin pjesë në zgjedhjet primare për zgjedhjen e kandidatëve të partisë për pozitat kryesore institucionale.

8.6. Të gjithë votuesit e Partisë Mundësia kanë detyrimin të:

- a) favorizojnë zgjerimin ndaj partisë në mjediset sociale ku janë të përfshirë;
- b) mbështesin me ndershmëri dhe luajalitet kandidatët e saj për pozitat institucionale në nivelet e ndryshme;
- c) të jenë konsistentë me deklarin e nënshkruar në momentin e regjistrimit në Regjistrin Publik të Votuesve.
- d) të respektojnë vlerat e kësaj partie dhe manifestojnë ato, gjatë veprimtarisë së tyre sociale dhe politike.

8.7. Anëtarët e Partisë Mundësia kanë gjithashtu detyrimin të:

- a) marrin pjesë aktivisht në jetën demokratike të partisë;
- b) kontribuojnë në financimin e partisë duke paguar rregullsisht kontributin vjetor të anëtarësisë;
- c) favorizojnë zgjerimin e pranive në partinë dhe pjesëmarrjen në momentet e hapura për të gjithë votuesit;
- d) respektojnë Statutin, shkeljet e të cilit mund të shkaktojnë ndëshkime të parashikuara në aktet e funksionimit të partisë.

8.8. Regjistrimi/Anëtarësimi në parti, si dhe regjistrimi në Regjistrin Publik të Votuesve mund të bëhet edhe në mënyrë elektronike, individualisht dhe mund të aplikohet vetëm pas mbushjes së moshës gjashtëmbëdhjetë vjeç. Përmbajtja, mbajtja dhe forma e publikimit të Regjistrin Publik të Votuesve, si dhe të Regjistrin të Anëtarëve, duhet të kryhet në përputhje me normat juridike dhe rregullat në fuqi për mbrojtjen e privatësisë së të dhënave personale, për të parandaluar ndikimet në veprimtarinë asociative të partisë, si dhe për të garantuar autonominë politike dhe për të siguruar transparencën e veprimtarive të saj.

KREU II DREJTIMI POLITIK, PËRBËRJA, MËNYRA E ZGJEDHJES DHE FUNKSIONET E ORGANET UDHËHEQËSE KOMBËTARE

NENI 9

KRYETARI I PARTISË

9.1. Kryetari përfaqëson Partinë, shpreh dhe përfaqëson adresimin politik të saj, bazuar në platformat apo programet politike që ka parashtruar në momentin e përzgjedhjes së tij si Kryetar i Partisë dhe propozohet nga Partia si kandidat për Kryeministër.

9.2. Nëse Kryetari shkarkohet apo jep dorëheqjen nga detyra para mbarimit të mandatit të tij, Kuvendi Kombëtar duhet të caktojë datën e zgjedhjeve të reja për kryetarin jo më vonë se tre muaj nga largimi.

9.3. Kryetari i Partisë gjatë veprimtarisë së tij të përditshme, i cakton detyra dhe fusha të caktuara përgjegjësie Nënkyetarëve të Partisë. Në mungesë të zgjatur të kryetarit dhe me autorizim të tij, njëri prej tyre zëvendëson Kryetarin.

9.4. Kryetari i Partisë në përmbushje të funksioneve të tij dhe garantimit të mbarëvajtjes së punës në parti, nxjerr urdhra dhe udhëzime, në bazë dhe për zbatim të këtij Statuti, si dhe të vendimeve të organeve drejtuese të Partisë.

NENI 10

KUVENDI KOMBËTAR

10.1. Kuvendi Kombëtar është organi më i lartë vendimmarrës i Partisë.

10.2. Kuvendi Kombëtar përbëhet nga njëqind e dyzet persona të zgjedhur sipas përcaktimeve të këtij statuti

10.3. Kuvendi Kombëtar, përveç të zgjedhurve, sipas përcaktimet të paragrafit 10.2., ka në përbërjen e tij për shkak të funksionit dhe subjektet e mëposhtme:

- a) Kryetari i Partisë;
- b) Nënkryetarët;
- c) Drejtuesit Politik të Bashkive;
- d) Kryetarët e Bashkive;
- e) Deputetët.

10.4. Kuvendi Kombëtar dhe organet udhëheqëse të zgjedhura nga ajo kanë kompetencë në çështje të drejtimit e politikës kombëtare të Partisë, në organizimin dhe funksionimin e të gjitha organeve udhëheqëse kombëtare. Kuvendi Kombëtar shpreh udhëzime në politikën e partisë përmes votimit të mocioneve, rezolutave, sipas mënyrave të paracaktuara në Rregulloren e saj, si nëpërmjet mbledhjeve plenare, ashtu edhe nëpërmjet Komisioneve të përhershme ose të përkohshme, ose, në raste të nevojës dhe urgjencës, përmes vendimeve të marra në mënyrë elektronike. Rregullorja miratohet nga Kuvendi me votën e 3/4 të anëtarëve të saj.

10.5. Kuvendi zgjedh me votim të fshehtë Kryetarin e saj. Në rast se asnjë kandidat nuk arrin në votimin e parë një numër votash të paktën të barabartë me shumicën e anëtarëve, menjëherë zhvillohet një votim i dytë, gjithashtu me votim të fshehtë, ndërmjet dy kandidatëve më të votuar. Kryetari i Kuvendit Kombëtar mbetet në detyrë për gjithë kohën e mandatit të Kuvendit.

10.6. Kuvendi thirret zakonisht nga Kryetari i saj së paku një herë në çdo gjashtë muaj. Në raste të jashtëzakonshme duhet të thirret nga Kryetari i saj nëse të paktën një e pesta e anëtarëve të saj e kërkojnë.

10.7. Kuvendi Kombëtar mund, me një mocion të arsyetuar, të miratuar me votën e 3/4 të anëtarëve të saj, të mosbesojë Kryetarin e Partisë. Nëse Kuvendi aprovon mocionin e mosbesimit për Kryetarin e Partisë, zhvillohen zgjedhje të reja për Kuvendin dhe Kryetarin e Partisë.

10.8. Kuvendi Kombëtar mund të rishikojë këtë statut, me votën e 3/4 të anëtarëve të saj.

NENI 11

KOHËZGJATJA E MANDATIT TË KRYETARIT TË PARTISË DHE TË KUVENDIT KOMBËTAR

11.1. Mandati i Kryetarit të Partisë dhe anëtarëve të zgjedhur të Kuvendit Kombëtar zgjat për një periudhë katër vjeçare.

11.2. Kryetari i Kuvendit Kombëtar përcakton zgjedhjet e Kuvendit dhe të Kryetarit të Partisë, gjashtë muaj përpara mbarimit të mandatit të Kryetarit të Partisë në fuqi. Kur ka shpërbërje të parakohshme, të parashikuara në këtë Statut, Kryetari i Kuvendit përcakton datën e zgjedhjeve brenda tre muajve në vijim.

NENI 12

NËNKRYETARËT

12.1. Kryetari i Partisë, në momentin e zgjedhjes së tij, i propozon Kuvendit Kombëtar përzgjedhjen e një ose dy nënkryetarëve.

12.2. Nënkryetarët kryejnë funksionet e deleguara nga Kryetari i Partisë.

NENI 13

SEKRETARIATI I PËRGJITHSHËM

13.1. Sekretariati është organi kolegjal që bashkëpunon me Kryetarin e Partisë dhe ka funksione ekzekutive.

13.2. Sekretariati përbëhet nga jo më shumë se pesëmbëdhjetë anëtarë, që emërohen nga Kryetari i Partisë, të cilat i komunikohen në një mbledhje të posaçme Kuvendit Kombëtar. Kryetari mund të revokojë një emërim të anëtarëve të Sekretariatit, duke i komunikuar në mënyrë të arsyetuar këtë vendimmarrje, Kuvendit Kombëtar.

13.3. Sekretariati mblidhet nga Kryetari, i cili është i detyruar të bëjë publike vendimmarrjet e saj.

13.4. Emërimet e tjera të cilat kanë të bëjnë me funksione të tjera ekzekutive përveç Sekretariatit, duhet të kryhen me aprovimin paraprak të Kuvendit Kombëtar.

NENI 14

HUMBJA E PARAKOHSHME E MANDATIT TË KRYETARIT TË PARTISË

14.1. Mandati i Kryetarit të Partisë përfundon në mënyrë të menjëhershme dhe automatike, në rastin kur Partia Mundësia, në zgjedhjet e përgjithshme kombëtare, siguron një rezultat më të ulët se ai i zgjedhjeve të mëparshme, përveç në rastin kur Partia siguron fitoren e zgjedhjeve dhe drejtimin e qeverisë.

14.2. Për qëllime të paragrafit të sipërcituar, për të përcaktuar rezultatin më të ulët se ai i zgjedhjeve të mëparshme, do të merren në konsideratë në mënyrë të pandashme përqindja e siguruar në rang kombëtar të votave të partisë si dhe numri i deputetëve të siguruar në legjislaturën përkatëse.

14.3. Për të përcaktuar rezultatin, pavarësisht kontestimeve që mund të ketë në lidhje me procesin zgjedhor, do të merren parasysh në mënyrë taksative vendimmarrjet përfundimtare dhe të paankimueshme të rezultateve nga ana e organeve zgjedhore shtetërore, në momentin e konstituimit të Parlamentit të ri të sapo zgjedhur.

NENI 15

ZGJEDHJA E KRYETARIT DHE KUVENDIT KOMBËTAR

15.1. Zgjedhja e Kryetarit të Partisë dhe Kuvendit Kombëtar normohet nga një Rregullore e miratuar nga Kuvendi Kombëtar me shumicë të cilësuar.

15.2. Mund të jenë kandidatë dhe të paraqesin kandidaturat e tyre, për Kryetar të Partisë dhe anëtarë të Kuvendit Kombëtar, vetëm anëtarët e regjistruar që përmbushin kërkesat e këtij statuti dhe janë të regjistruar në regjistrin përkatës, të paktën 4 muaj, përpara datës së zgjedhjeve.

15.3. Rregullorja e përcaktuar në paragrafin e parë, përcakton kohën dhe mënyrën e zhvillimit të takimeve me anëtarësinë dhe zgjedhësit, të kandidatëve, të konventave rajonale apo dhe kombëtare, gjatë të cilave prezantohen platformat politiko – programore, të propozuara nga kandidatët për Kryetar Partie, duke u zhvilluar një debat i hapur me të gjithë zgjedhësit e Partisë Mundësia.

15.4. Kryetari i Partisë dhe anëtarët e Kuvendit Kombëtar zgjidhen me votim të fshehtë, sipas parimit “Një anëtar, Një votë”. Modalitetet e procesit zgjedhor përcaktohen në Rregulloren, sipas paragrafit të parë të këtij neni.

15.5. Kuvendi Kombëtar do të përbëhet nga aq anëtarë të zgjedhur, sa janë dhe deputetët e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë. Gjithashtu, po sipas ndarjes elektorale të përcaktuar në Kodin Zgjedhor, çdo qark do të ketë aq anëtarë sa dhe është numri total i deputetëve të përcaktuar në atë periudhë për atë qark. Në përbërjen e listave zgjedhore për anëtarët e Kuvendit Kombëtar duhet të respektohen parimi i barazisë gjinore, kur kjo është e mundur. Çdo aspekt tjetër procedural që nuk përcaktohet në statut, do të normohet në Rregulloren e përcaktuar në paragrafin e parë, e cila përditësohet në varësi edhe të ndarjes administrativo territoriale por dhe të ndryshimeve të Kodit Zgjedhor.

15.6. Kandidati që merr numrin më të madh të votave të vlefshme nga anëtarësia, shpallet dhe Kryetari i Partisë.

NENI 16 ORGANIZIMI I PARTISË JASHTË

16.1. Partia Mundësia, për të garantuar pjesëmarrjen politike, sociale dhe kulturore të shqiptarëve që jetojnë jashtë vendit, organizon strukturat e saj edhe në vende të tjera.

16.2 Format dhe mënyrat e organizimit të Partisë Mundësia jashtë vendit përcaktohen me rregullore të miratuar nga Sekretariati.

KREU III ORGANIZIMI I PARTISË NË NIVELIN E BAZËS

NENI 17 BËRTHAMA

17.1. Organizimi bazë i Partisë Mundësia është Bërthama.

17.2. Çdo anëtar ka të drejtë të krijojë një bërthamë, pa kufizime territoriale, duke përdorur Platformën Mundësia.

17.3. Është detyrim i organeve drejtuese të partisë, që të krijojnë minimalisht një Bërthamë në çdo qendër votimi.

17.4. Bërthama ka si strukturë të saj Kryetarin/Themeluesin dhe Sekretarin, i cili zgjidhet nga kryetari.

17.5. Bërthama e Partisë Mundësia formohet me të paktën 5 anëtarë.

17.6. Organizimi i bërthamave është një aspekt shumë i rëndësishëm për zhvillimin e mendimit ndryshe dhe përfaqësimit të anëtarësisë jo vetëm në aspektin territorial por dhe në atë të mendimeve apo të qendrave të interesit. Bërthamat mund të ndajnë mendime ndryshe dhe të bëhen faktor i rëndësishëm në zhvillimin dhe orientimin politik të partisë, duke synuar pikërisht një përfaqësim horizontal të partisë dhe jo vetëm drejtimin politik vertikal dhe territorial.

NENI 18

QENDRA E KOORDINIMIT TË NJËSISË ADMINISTRATIVE (QKNJA)

18.1. Qendra e Koordinimit të Njesisë Administrative (QKNJA) i bashkon anëtarët dhe votuesit e një territori të caktuar gjeografik, që korrespondon me njësitë administrative sipas ndarjes territoriale, brenda Partisë Mundësia.

18.2. Pozicionet drejtuese të QKNJA janë si vijon:

- a) Këshilli Drejtues;
- b) Koordinatori;
- c) Sekretari;

18.3. Këshilli Drejtues dhe Koordinatori, zgjidhen nga anëtarësia, me parimin një anëtar një votë. Numri i anëtarëve të Këshillit Drejtues përcaktohet në proporcion me numrin e bërthamave.

18.4. Këshilli Drejtues mbledhet së paku dy herë në muaj, duke marrë në shqyrtim situatën politike dhe ekonomike brenda territorit të tij, inicion dhe ndërmerr veprime në konsultim dhe me organet drejtuese, sikundër dhe në bashkëpunim me anëtarët, votuesit dhe qytetarët.

NENI 19

INTERPERLANCA

19.1. Anëtarët e Këshillit Drejtues kanë të drejtë të thërrasin në interpelancë Koordinatorin, si dhe ta mosbesojnë atë me shumicë të cilësuar votash.

a. Interpelanca thirret me kërkesën e nënshkruar nga 1/5 e anëtarëve të Këshillit Drejtues të QKNJA.

b. Gjatë një interpelance palët kanë të drejtë t'i parashtrojnë opinionet dhe faktet e tyre si dhe të kërkojnë zgjedhje të parakohshme për Koordinatorin apo dhe për vetë Këshillin Drejtues.

c. Vendimi për zgjedhje të parakohshme merret me shumicë të cilësuar votash, në mbledhjet që e përmbushin kuorumin.

ç. Pas marrjes së vendimit për zgjedhje të parakohshme, zgjedhjet e parakohshme mbahen jo më larg se tre muaj.

NENI 20

DETYRAT E KËSHILLIT DREJTUES

20.1. Detyrat dhe përgjegjësitë e Këshillit Drejtues të QKNJA janë si në vijim:

- a. Të nxisë dhe të kultivojë frymën e veprimit brenda territorit ku i zhvillon aktivitetet;
- b. Të identifikojë problemet kryesore të territorit që mbulon;

- c. Të votojë për zgjidhjen sa më të shpejtë dhe më efikase të këtyre problemeve, në përputhje me parimet dhe me dokumentet themeltare të Partisë;
- ç. Të hartojë politikat dhe strategjitë e zhvillimit të njësisë administrative që mbulon;
- d. Të koordinojë aktivitetet me njësitë e tjera;
- dh. Të ndjekë dhe të zbatojë udhëzimet dhe vendimet politike të Këshillit Drejtues të Qendrës së Koordinimit të Bashkisë, si dhe të ndjekë udhëzimet dhe vendimet e organeve qendrore;
- ë. Të bëjë ndarjen midis statusit të anëtarit dhe votuesit, duke i respektuar nenet e këtij Statuti;
- f. Të krijojë komisione dhe grupe pune për zbatimin e vendimeve të veçanta që nuk janë parashikuar në Statut;
- g. Të rekrutojë anëtarë dhe votues të rinj dhe ta sigurojë mbrojtjen e të drejtave të tyre;
- g. Të grumbullojë kuotën e anëtarësisë dhe ta përdorë atë për të mbuluar shpenzimet përkatëse administrative dhe logjistike, si dhe të kontribuojë në buxhetin e e partisë, duke e alokuar minimalisht 20% të shumës së kësaj kuote për çdo vit;
- i. Të shërbejë si organ ndërlidhës midis individëve dhe pushtetit vendor ose midis individëve dhe autoriteteve të tjera të territorit, për t'i zgjidhur problemet e individëve dhe për t'i ndihmuar ata në realizimin e aspiratave të tyre në përputhje me parimet dhe me dokumentet themeltare të partisë;
- j. Të organizojë aksione politike dhe aktivitete sociale, kulturore dhe edukative në bashkëpunim me bashkësinë e individëve të territorit që mbulon, me shoqërinë civile dhe me strukturat e tjera të partisë;
- k. Të angazhohet në formimin politik të anëtarëve dhe votuesve të QKNJA.

NENI 21 SEKRETARI I QKNJA

21.1. Detyrat dhe përgjegjësitë e Sekretarit të QKNJA përfshijnë:

- a. Zbatimin e vendimeve të Këshillit Drejtues, Koordinatorit dhe organeve të tjera sipas hierarkisë organizative të përcaktuar me këtë Statut;
- b. Marrja e vendimeve për organizimin e strukturave;
- ç. Ngritja e çfarëdo çështje që përfshinë situatën aktuale politike dhe ekonomike brenda territorit të Njësisë;
- d. Inicion veprime, përfshihet dhe organizon aktivitete të ndryshme komunitare dhe ndërmerr veprime politike në konsultim me organet kompetente të Njësisë Administrative; dhe

NENI 22 KOORDINATORI I QKNJA

22.1. Koordinator i QKNJA zgjidhet në mesin e anëtarëve të asaj njësie administrative, nga vetë anëtarët e saj.

22.2. Detyrat dhe përgjegjësitë e Koordinatorit të QKNJA janë si në vijim:

- a. E thërret dhe e drejton Këshillin Drejtues në mbledhje të zakonshme dhe të jashtëzakonshme;
- b. I drejton mbledhjet e Këshillit Drejtues dhe e vendos rendin e ditës së mbledhjes,

duke i marrë parasysh propozimet e anëtarëve të Këshillit, sipas udhëzimeve dhe vendimeve të miratuara nga organet qendrore;

c. E drejton punën e përditshme të QKNJA, sipas orientimeve të Këshillit Drejtues;

ç. E përfaqëson QKNJA me palë të treta;

d. Merr pjesë në mbledhjet e Këshillit të Qendrës së Koordinimit të Bashkisë si anëtar i këtij Këshilli.

KREU IV ORGANIZIMI I PARTISË NË NIVELIN E DYTË

NENI 23 QENDRA E KOORDINIMIT NË BASHKISË (QKB)

23.1. Qendra e Koordinimit në Bashki e Partisë Mundësia përbën nivelin e dytë organizativ të kësaj partie. Ajo është strukturë, që i bashkon QKNJA e një hapësire të caktuar gjeografike.

23.2. Qendra e Koordinimit në Bashki e Partisë Mundësia është e përbërë nga këto organe:

- a. Drejtuesi Politik i QKB,
- b. Sekretariati i QKB,
- c. Këshilli i QKB.

NENI 24 KËSHILLI I QKB

24.1. Këshilli i QKB, përbëhet nga koordinatorët e QKNJA dhe anëtarët e Këshillit Bashkiak. Këshilli i QKB ka të drejtën ta thërrasin në interpelancë Drejtuesin Politik.

24.2. Interpelanca thirret me kërkesën e nënshkruar nga 1/5 e anëtarëve të Këshillit të QKB. Gjatë një interpelance palët kanë të drejtë t'i parashtrajnë opinionet dhe faktet e tyre, si dhe të kërkojnë zgjedhje të parakohshme për Drejtuesin Politik. Vendimi për zgjedhje të parakohshme për Drejtuesin Politik merret me shumicë të cilësuar votash, në mbledhjet që përmbushin kuorumin.

24.3. Pas marrjes së vendimit për zgjedhje të parakohshme, zgjedhjet e parakohshme mbahen jo më vonë se tre muaj.

24.4. Këshilli i QKB është organi më i lartë vendimmarrës i Partisë Mundësia në nivelin e dytë organizativ, në rang territori bashkiak. Këshilli i QKB ka detyrat dhe përgjegjësitë në vijim:

a. Të nxisë dhe ta kultivojë frymën e veprimit brenda territorit ku zhvillon aktivitetet;

b. Të hartojë politikat dhe strategjitë e zhvillimit të territorit;

c. Të miratojë një herë në gjashtë muaj numrin e anëtarëve për secilën QKNJA;

ç. Të ndjekë dhe të zbatojë udhëzimet dhe vendimet e Kuvendit Kombëtar për

çështje të përbashkëta të QKB të partisë;

d. Të miratojë dhe të mbikëqyrë buxhetin vjetor të QKB;

e. Të zgjedhë Komisionin Disiplinor të QKB;

f. Të krijojë komisione dhe grupe pune për zbatimin e vendimeve të veçanta, që nuk janë parashikuar në këtë Statut;

g. Të shërbejë si mjet ndërlidhës midis individëve dhe pushtetit vendor ose midis individëve dhe autoriteteve të tjera të territorit, që QKB mbulon, për t'i zgjidhur problemet e individëve dhe për t'i ndihmuar ata në realizimin e aspiratave të tyre në përputhje me parimet dhe me dokumentet themeltare të partisë;

gj. Të nxisë organizimin e aksioneve politike, si dhe të aktiviteteve sociale dhe edukative në bashkëpunim me bashkësinë e individëve të territorit që mbulon, me shoqërinë civile dhe me strukturat e tjera të partisë.

24.5. Numri i anëtarëve të Këshillit të QKB është i ndërruar në bazë të numrit të:

a. Koordinatorëve të QKNJA,

b. Këshilltarëve Bashkiakë që përfaqësojnë Partinë Mundësia në pushtetin lokal,

24.6. Mbledhjet e zakonshme të Këshillit të QKB mbahen të paktën një herë në tre muaj, në ditët e caktuara nga ky i fundit.

Mbledhjet e jashtëzakonshme të Këshillit të QKB thirren nga një prej mënyrave në vijim:

a. Me kërkesë të Drejtuesit Politik të QKB, që njëkohësisht është dhe Kryetari i Këshillit;

b. Me kërkesë të Sekretarit të QKB;

c. Me një kërkesë me shkrim, të nënshkruar nga 1/5 e anëtarëve të Këshillit të QKB;

NENI 25 SEKRETARIATI I QKB

25.1. Sekretariati i QKB përbëhet nga 4 deri në 11 anëtarë që zbatojnë politikat e Partisë Mundësia dhe marrin vendime afatshkurtra, në rastin kur këto vendime nuk i kundërvihen vendimeve të Këshillit të QKB.

25.2. Kuorumi i mbledhjeve të Sekretariatit të QKB përmbushet me pjesëmarrjen e 50% + 1 të anëtarëve të tij. Mbledhjet e jashtëzakonshme të Sekretariatit të Qendrës thirren me:

a. Kërkesën e Drejtuesit Politik,

b. Kërkesën e së paku 1/3 e anëtarëve të Sekretariatit.

Në rast se për një vendim të Sekretariatit të Qendrës kemi vota të barabarta, atëherë vendos vota e Drejtuesit Politik.

Sekretariati i Qendrës përbëhet nga:

a. Drejtuesi Politik;

b. Dy Nënkyetarët e QKB;

c. Sekretari Organizativ;

d. Anëtarët që propozohen nga Drejtuesi Politik dhe miratohen nga Këshilli i QKB.

25.3. Detyrat dhe përgjegjësitë e Sekretariatit të QKB përfshijnë:

- a. Zbatimin e vendimeve të Këshillit të QKB;
- b. Organizimi i proceseve në parti në nivelin bashkiak;
- d. Marrja e vendimeve për të ngritur çështje të ndryshme në institucionet publike përmes përfaqësuesve të partisë në këto institucione;
- dh. Marrja e vendimeve për të ngritur çështje të ndryshme për t'u zbatuar nga organet ekzekutive dhe këshilluese të QKB përkatëse;

NENI 26 DREJTUESI POLITIK I QKB

26.1. Drejtuesi Politik i QKB zgjidhet me shumicë të thjeshtë votash nga anëtarët e një QKB. Nëse Drejtuesit Politik i ndërpritet mandati parakohe, atëherë njëkohësisht i ndërpritën edhe të gjitha mandatet e tjera që mund të ketë në nivelin kombëtar organizativ.

26.2. Drejtuesi Politik ka detyrat dhe përgjegjësitë në vijim:

- a. Thërret dhe drejton mbledhjet e zakonshme dhe të jashtëzakonshme të Sekretariatit;
- b. Raporton dhe përgjigjet për punën dhe për aktivitetet, që zhvillon QKB pranë Këshillit të saj;
- c. Përfaqëson partinë me palë të treta në territorin që mbulon QKB;
- ç. Propozon Nënkryetarin e QKB dhe anëtarët e Sekretariatit;
- d. Bashkërendon politikat e QKB me Sekretariatin e Përgjithshëm.

KREU V FINANCIMI

NENI 27 BURIMET FINANCIARE TË PARTISË

27.1. Burimet financiare të Partisë Mundësia janë:

- a. Të ardhurat nga kuotat e anëtarësisë;
- b. Të ardhurat nga buxheti i shtetit të akorduara për subjektet politike;
- c. Ndihmat dhe dhuratat e votuesve, të anëtarëve dhe të mbështetësve të Partisë Mundësia;
- ç. Ndihmat dhe dhuratat e organizatave partnere;

Çdo entitet fizik apo juridik, individ apo organizim, që do të kontribuojë për Partinë Mundësia, duhet të jetë i identifikueshëm. Çdo kontribues mund të zgjedhë që emri i tij mos të bëhet publik, me përjashtim të rastit kur kontributi tejkalon shumën prej 1.000.000 Lek.

27.2. Veprimtaria financiare dhe ekonomike e Partisë Mundësia menaxhohet nga nga Sekretari për Financat, pranë Sekretariatit të Përgjithshëm dhe kontrollohet nga Kuvendi Kombëtar

27.3. Raportet financiare, janë transparente dhe të aksesueshme për të gjithë, për shkak se publikimi i tyre është i detyrueshëm në faqen zyrtare të internetit të partisë.

27.4. Burimet financiare të Partisë Mundësia janë të kufizuara si në vijim:

a. Kontributi financiar për Partinë Mundësia i personave fizik ose juridik do të kryhet vetëm në përputhje me përcaktimet ligjore në fuqi, kur kryhet ky kontribut;

b. Partia Mundësia nuk pranon financime nga persona fizik dhe juridik që e kanë zhvilluar aktivitetin e tyre ekonomik nëpërmjet krimit të organizuar dhe aktiviteteve të tjera të jashtëligjshme;

c. Partia Mundësia nuk pranon financime nga persona fizik dhe juridik, që refuzojnë të bëhen publik, sipas përcaktimeve të pikës 27.1. të këtij neni.

27.5. Partia Mundësia duhet të posedojë vetëm një llogari bankare në Republikën e Shqipërisë, përmes së cilës realizohen të gjitha transaksionet. Nëse është e domosdoshme partia mund të posedojë dhe llogari të ndërruarura në valutat e tjera, po brenda të njëjtit institucion bankar ku zotërohet llogaria primare.

KREU VI

PËRZGJEDHJA E PËRFAQËSUESVE TË INSTITUCIONEVE DHE KOMISIONET

NENI 28

PËRZGJEDHJA E FUNKSIONARËVE POLITIKË

28.1. Demokracia e brendshme dhe kolegjaliteti zbatohet edhe në përcaktimin e kandidaturave elektorale të partisë, sipas parimit të procesit të primareve. Anëtarët e partisë kanë të drejtën e identifikimit dhe propozimit të kandidaturave të mundshme elektorale.

28.2. Kandidaturat për zgjedhjet në Kuvendin e Shqipërisë, Këshillat Bashkiak apo për Kryetar Bashkie seleksionohen në bashkëpunim dhe konsultim aktiv me anëtarët e Partisë.

28.3. Rregullat e detajuara për realizimin e procesit të propozimit, përzgjedhjes, konsultimit, votimit dhe caktimit të kandidaturave elektorale të partisë, përcaktohen me vendim të Kuvendit Kombëtar.

NENI 29

KOMISIONI DISIPLINOR

29.1. Komisionet disiplinore krijohen në rangun e QKB dhe në rang të nivelit kombëtar. Në rangun e QKB, çdo Këshill duhet të krijojë komisionin disiplinor të përbërë nga pesë anëtarë, të cilët propozohen dhe zgjidhen në mesin e anëtarëve të Këshillit të QKB, po nga këta të fundit.

29.2. Në nivelin kombëtar krijohet Komisioni i Përgjithshëm i Disiplinës, i cili përbëhet nga pesë anëtarë, të cilët zgjidhen nga Kuvendi Kombëtar, me propozim të Kryetarit të Partisë.

29.3. Anëtarët dhe votuesit e partisë, kanë të drejtë të paraqesin fillimisht ankesë për çdo anëtar apo votues të partisë, pranë Komisionit Disiplinor të QKB. Kundër

vendimit të Komisionit Disiplinor të QKB, subjekti i interesuar ka të drejtë ti drejtohet, brenda 30 ditëve nga marrja dijeni e vendimit të arsyetuar, Komisionit Disiplinor të Përgjithshëm, i cili merr vendim përfundimtar.

29.4. Për çdo votues apo anëtar që vërtetohet se ka vepruar në kundërshtim me këtë statut, me ligjin, aktet e brendshme të kësaj organizate politike, apo në kundërshtim me vlerat që kjo parti mbart, në varësi të shkeljeve, nga komisionet disiplinore merren këto masa:

- Vërejtje me shkrim;
- Heqja nga cilido pozicion brenda partisë;
- Pezullimi i përkohshëm ose i përhershëm për të kandiduar në përfaqësim pranë organeve publike;
- Përfshirja në listën e partisë.

NENI 30 KOMISIONET ZGJEDHORE

30.1. Komisionet zgjedhore ngrihen pranë çdo QKB, dhe përbëhen nga pesë anëtarë, ku njëri prej tyre kryen dhe rolin e sekretarit. Komisionet Zgjedhore pranë çdo QKB garantojnë funksionimin e zgjedhjeve që kryhen pranë qendrave territoriale që ato mbulojnë.

30.2. Anëtarët e Komisionit Zgjedhor propozohen dhe zgjidhen në mesin e anëtarëve të Këshillit të QKB, po nga këta të fundit.

30.3. Në rang kombëtar ngrihet Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, i cili drejton dhe kontrollon veprimtarinë e Komisioneve Zgjedhore në QKB, sikundër është organ i cili shqyrton ankesat kundër vendimeve apo veprimeve të këtyre të fundit.

30.4. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve përbëhet nga pesë anëtarë, të cilët propozohen dhe zgjidhen në mesin e anëtarëve të Kuvendit Kombëtar, po nga këta të fundit. Kundër vendimeve të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve nuk lejohet ankimi.

KREU VII DISPOZITA TË TJERA DHE KALIMTARE

NENI 31 MANDATET

31.1. Ku nuk është përcaktuar shprehimisht në këtë statut, çdolloj mandati, i çdolloj funksioni apo organi kolegjal, ka një afat prej 4 – vitesh. Për efekte të paparashikuara apo të jashtëzakonshme, apo të pamundësisë objektive këto mandate mund të zgjasin edhe përtej një afati gjashtë mujor, përtej skadencës, por asnjëherë më shumë se gjashtë muaj dhe vetëm për arsye të përligjura.

31.2. Çdokush që zotëron një mandat, duhet të jetë zgjedhur në një nga mënyrat e këtij statuti dhe në respektim të këtij statuti, për këtë arsye çdolloj zgjedhje apo funksioni i mbajtur në kundërshtim me këtë statut është i paligjshëm dhe absolutisht i pavlefshëm, duke legjitimuar çdo anëtar që ti drejtohet gjykatës kompetente për të konstatuar këtë paligjshmëri.

NENI 32

PLATFORMA MUNDËSIA

32.1. Duke qenë se trasparenca, respektimi i mendimit ndryshe dhe ndërveprimi, janë disa prej parimeve thelbësore të partisë, nga ana e Sekretariatit të Përgjithshëm, do të ngrihet dhe adaptohet një platformë elektronike që të mundësojë të gjithë anëtarët dhe votuesit e regjistruar të partisë të ndërveprojnë dhe të shfaqin mendimet e tyre.

32.2. Platforma Mundësia, do të sigurojë regjistrimin e anëtarëve dhe votuesve, në mënyrë të shpejtë dhe elektronike, duke krijuar dhe regjistrat përkatëse për këto dy subjekte. Të dhënat personale dhe çdo lloj e dhëne tjetër që do të jepet nga anëtarët dhe votuesit, duhet të garantojnë respektimin e të gjithë dispozitave ligjore në fuqi në lidhje me trajtimin e të dhënave personale.

32.3. Në Platformën Mundësia, duhet të lejohet dhe ndërveprimi apo publikimet e ndryshme midis anëtarëve dhe votuesve, të cilët kanë të drejtë të ngrenë dhe “bërthamat” e tyre të anëtarëve apo votuesve. Çdo anëtar i partisë, mund të krijojë bërthamat e veta, me anëtarë apo votues të partisë, pavarësisht vendndodhjes territoriale të tyre, brenda apo dhe jashtë vendit.

32.4. Platforma Mundësia, duhet të mundësojë dhe trasparencën e vendimmarrjeve të organeve përkatëse të partisë, si në rang kombëtar por dhe qendër, sikundër duhet të bëjë transparente financimin e saj dhe shpenzimet që kryhen nga organet përkatëse të partisë.

32.5. Platforma Mundësia duhet të garantojë që nëpërmjet saj të kryhen dhe votimet sipas këtij statuti. Ajo duhet të garantojë të gjitha standardet për identifikimin e votuesve, lehtësinë e përdorimit të saj, fshehtësinë e votimit sikundër dhe paprekshmërinë e rezultatit dhe pamundësinë për ndryshimin e tij. Përgjegjës për respektimin e këtyre standardeve është Sekretariati i Përgjithshëm, i cili duhet sa më shpejt të mundësojë votimin elektronik nëpërmjet platformës.

NENI 33

DISPOZITA KALIMTARE

33.1. Në përputhje me përcaktimet ligjore dhe nënligjore në fuqi, me qëllim funksionimin e saj dhe organizimin sa më të shpejtë për zgjedhjet e ardhshme parlamentare, anëtarët themelues të Partisë Mundësia zgjedhin si kryetar të parë të kësaj partie, nismëtarin themelues, **z. Agron Siri Shehaj**, i datëlindjes 08.12.1977, lindur në Vlorë dhe banues në Tiranë, Rruga “Sami Frashëri”, nr. 5.

33.2. Me miratimin e këtij statuti, konstituohet përkohësisht Këshilli Drejtues Provizor, i Partisë Mundësia, i përbërë prej tetë anëtarësh, që së bashku me Kryetarin e Partisë, kanë për detyrë të bëjnë organizimin e partisë dhe të fillojnë menjëherë me ngritjen e Sekretariatit të Përgjithshëm dhe krijimin e kushteve për zhvillimin e zgjedhjeve të Kuvendit Kombëtar dhe organeve të tjera nëpër QKB, brenda 31.12.2024. Këshilli Drejtues Provizor shkrihet me konstituimin e Kuvendit Kombëtar.

33.3. Me ngritjen dhe funksionimin e organeve kryesore të drejtimit të partisë, këto të fundit, sipas kompetencave përkatëse, kanë detyrimin për të hartuar dhe miratuar aktet

e brendshme të partisë, si rregullore, vendime, kode, udhëzime, me qëllim funksionimin normal të punës së tyre.

NENI 34
HYRJA NË FUQI

Ky Statut hyn në fuqi të nesërmen e miratimit të tij nga Konventa Themeluese e Partisë Mundësia, në datën 02.06.2024.